



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[27.06.2024]

Drejtuar: **JUBICA.sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z.Ndoc Kulla, me NUIS K26529001I. Adresa: Rruga Luigj Gurakuqi, Kuklejt, nr 108 , Shkoder.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-98654-03-18-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës:”**Permiresimi i Sinjalistikes Horizontale dhe Vertikale në segmentet kryesore, Bashkia Shkoder**”

Fondi limit **41,309,221(Dyzet e njemilion e treqind e nentemije e dyqind e njetzet e nje)** lekë pa tvsh

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [25.03.2024] [16]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **RSM COMPANY** shpk me NIPT 810802422 Shoqeria meme e **Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h** përfaqësuar nga administratori zj. Elida Kola me NUIS L04803001U  
Vlera **28,953,815** (Njetzet e tetemilion e nenteqind e pesedhete e tre mije e teteqind e pesembedhete) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik **JUBICA sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z.Ndoc Kulla, me NUIS K26529001I.

Vlera **37,950,000** (Tridhjetë e shtatë milion e nentëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

3. Operatori ekonomik **I.D.K - KONSTRUKSION sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z. Gramos Dalipi, me NIPT K51408016J.  
Vlera **40,276,490** (Dyzet milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nentëdhjetë) lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik **"METEO" sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z. Erind Bengu, me NUIS L26310801C.  
Vlera **40,772,201** (Dyzet milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e një) lekë pa tvsh.
5. Operatori ekonomik **"DELTAREX" sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z. Artur Bisha, me NUIS L92314031R.  
Vlera **40,443,036** (Dyzet milion e katërqind e dyzet e tremijë e tridhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. U skualifikua operatori ekonomik **RSM COMPANY shpk** me NIPT 810802422 Shoqëria meme e **Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company" d.sh.h** me NUIS L04803001U, për këto arsye:

1- Oferta juaj pas realizimit të rivlerësimit në zbatim të vendimit të KPP, rezultoj anomalisht e ulët në bazë të formulës së përcaktuar në DST, bazuar në nenin 93, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu X, Neni 82, pika 4, nga shqyrtimin i analizave të sjella rezultojn se:

#### **1. Segmenti i unazës lindore 5500 mL**

1-Ne zerin me nr.AN 3.943/3"Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjerësi 15cm.Termoplastike (sprajt)", cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** është vendosur nga ana juaj në vlerën **418.96** leke.

2-Ne zerin e preventivit me nr.AN 3.942/3" **Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjerësi 12 cm.Termoplastike (sprajt ) për korsinë e bicikletave"**, cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** është vendosur nga ana juaj **523.69** leke.

#### **5. Segmenti Rotondo Spitali - Fermentim - Rotondo Bardhaj 2300 mL**

1-Ne zerin e preventivit me nr.AN 3.943/3" **Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjerësi 15.Termoplastike (sprajt)"**, cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** është vendosur nga ana juaj **335.88** leke.

2-Ne zerin e preventivit me nr.AN 3.943/3 "Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjerësi 15,Termoplastike (sprajt) për vijën e mesit", cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** është vendosur nga ana juaj **335.88** leke.

3-Ne zerin e preventivit me nr.AN 3.943/3 "Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjerësi 15,Termoplastike (sprajt) për vijën e mesit", cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** është vendosur nga ana juaj **335.88** leke.

4-Ne zerin e preventivit me nr.AN 3.942/3” **Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm Termoplastike (sprajt) per korisne e bicikletave**”, cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** eshte vendosur nga ana juaj **420** leke.

#### **6. Segmenti Sheshi Demokracia- Stacioni I trenit 1500 mL**

1-Ne zerin e preventivit me nr.AN 3.943/3” **Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15.Termoplastike (sprajt)**”, cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** eshte vendosur nga ana juaj **391.26** leke.

2-Ne zerin e preventivit me nr.AN 3.943/3” **Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15.Termoplastike (sprajt) per vijen e mesit**”, cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** eshte vendosur nga ana juaj **391.26** leke.

#### **7. Segmenti Rotondo Policise - Fermentim 1100 mL**

1-Ne zerin e preventivit me nr.AN 3.943/3” **Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 Termoplastike (sprajt)**”, cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** eshte vendosur nga ana juaj **418.96** leke.

2-Ne zerin e preventivit me nr.AN 3.943/3” **Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 Termoplastike (sprajt) per vijen e mesit**”, cmimi tek zeri material **Boje termoplastike (sprajt)** eshte vendosur nga ana juaj **418.96** leke.

**Së pari,**

Per te justifikuar zerin material **Boje termoplastike (sprajt)** keni lidhur nje kontrate furnizimi me shoqerine “**AE Team**” Sh.p.k. ku kjo shoqeri merr persiper furnizimin me Boje termoplastike (sprajt) me cmim **335.88** leke/kg , cmim qe nuk korrespondon pothuajse me asnje prej cmimeve te deklaruara ne analizat e cmimeve dhe nuk e justifikon aspak cmimet e ndryshme per te njejtin produkt..

Nga ana tjeter cmimi per njesi ne manualin e çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim per materialin **Boje termoplastike (sprajt)** eshte **650 leke/kg** qe eshte 2 here me I larte se cmimi prej **335.88** leke/kg.

Bazuar ne Vendimin nr.216, datë 13.4.2023”Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, citohet si me poshte:

**Neni 9/2** Manuali i çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim pasqyron situatën aktuale të çmimeve të mesatarizuara të materialeve të ndërtimit dhe produkteve për ndërtim, të ofruara nga tregu përkatës, brenda vendit në çdo moment të kohës.

**Neni 11** Sistemi i integruar i manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet informacionit të ardhur nga subjektet publike dhe/ose private, që kryejnë veprimtari në fushën e ndërtimit, të prodhimit të materialeve të ndërtimit, si dhe të tregtimit të tyre, nëpërmjet këtij sistemi, sipas strukturës së kostos së punimeve të ndërtimit, të përcaktuar në aktet ligjore në fuqi.

**Neni 12** Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit nëpërmjet shërbimit të dedikuar elektronik në portalin unik qeveritar e-Albania, paraqesin analizat teknike dhe çmimet për çdo zë pune në ndërtim, për materialet e reja dhe/ose për teknologjitë e reja, të përdorura prej tyre, për të cilat nuk ekziston një analizë teknike e çmimit në manualin elektronik. Analizat teknike paraqiten në përputhje me metodologjinë e parashikuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Nisur nga me lart çmimet e manualit çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim janë cmime te perditesuara dhe qe nuk lene hapësire per diferenca te medha te cmimeve te materialeve te ndertimit nga subjektet ofertues.

Dokumentacioni qe keni paraqitur , kontrate furnizimi me subjektin “AE Team” Sh.p.k. nuk e justifikon cmimin prej **335.88** leke/kg

Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore

KVO gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën.

Keto kushte duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët

Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës.

Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në argumentimin e ofertës anomalisht të ulet e konkretisht në atë të zerit material **Boje termoplastike (sprajt)**, ky dokumentacion konsiderohet i mangët, pasi shoqëria “AE Team” Sh.p.k. e cila merr përsipër furnizimin me cmime të uleta nuk është vetë prodhuese por importuese e bojërave dhe normalisht do duhej të paraqitej fatura doganore/fatura tatimore/autorizimi I prodhuesit/skeda teknike duke mos plotësuar kështu pikë b dhe c të nenit 93 të LPP dhe nuk krijon bindjen të KVO se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme dhe përputhjen me specifikimet teknike të kërkuara.

Gjithashtu nga ofertuesi nuk është paraqitur ndonjë zgjidhje teknike ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që për furnizimin e produkteve me kosto të ulet ose për kryerjen e punës

### **Së dyti,**

Nga shqyrtimi i analizave rezulton se për të njëjtin zë analize, zërin material **Boje termoplastike (sprajt)**, si element i strukturës së kostos, keni dhënë cmime të ndryshme si **418.96** leke, **523.69** leke, **335.88** leke, **420** leke, **391.26** leke dhe **418.96** leke.

Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike të publikuara ka të përcaktuar qartë specifikimet teknike për Boje termoplastike (sprajt) që nuk lenë asnjë dyshim se mund të kemi lloje të ndryshme bojë termosplastike për të ofruar me cmime të ndryshme për njësi. Nisur nga ky konstatim i gjetur në analizat e cmimeve, KVO verën se edhe në preventivin e punimeve të paraqitur në tender për zerin me nr. AN 3.943/3 “Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15cm.Termoplastike (sprajt)” keni ofertuar me cmime të ndryshme si 230 leke, 200 leke dhe 220 leke, konstatim që nuk është verejtur në shqyrtimin e ofertave herën e parë.

KVO mendon se ofertuesi nuk ka asnjë arsye dhe asnjë bazë ku të mbështetet për të dhënë për të njëjtin zë manuali cmime të ndryshme e aq me shumë për të njëjtin zë material **Boje termoplastike (sprajt)**.

Kjo gjë bie ndesh me Vendimin nr. 216, datë 13.4.2023”Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Gjithashtu kjo gjë bie ndesh me parashikimet e germës a) të pikës 1 të nenit 39 Kërkesat e Veçanta për kontratat për punët publike, ku është përcaktuar se:

1. Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projektpreventiv mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.

Per sa i perket justifikimit te cmimit per zerin material tabela rrugore treguese 150x40cm Tabele katrore normal me A=60 per kembesore eshte paraqitur nje kontrate furnizimi mes shoqerise "RSM Company" me seli ne Cakllavice, Prishtine,dhe Shoqerise **Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h.** qe eshte dega shqiptare e kesaj shoqerie ku shoqeria "RSM Company" **Sh.p.k** merr persiper furnizimin me tabela per shoqerine **Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h.** ne nje kohe qe eshte vete shoqeria "RSM Company" qe ka aplikuar ne sistemin e APP duke qene vete ofertuese ne kete procedure prokurimigje qe krijon bindjen te KVO qe kjo kontrate eshte thjesht formale.

Eshte detyre e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi duke dhene prova bindese.

KVO gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangjen e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët.

KVO gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

**2-U skualifikuan operatori ekonomik "METEO"sh.p.k, me NUIS L26310801C, për këto arsye:**

-Nuk keni paraqitur formularin e sigurimit te ofertes sipas shtojces 3

-Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 8 keni deklaruar se keni 4 punonjes nga 50 qe kerkohen

- Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit sioas shtojces 8 nuk keni deklaruar se dispononi

1-Automjet Vijëzimi per Boje Termoplastike (APV me leje qarkullimi) me kapacitet minimumi 4 tone

2-Makineri vijëzimi me bojë Bikomponente me kapacitet minimumi 400 liter

3- Kamion me vinç të integruar

-Nuk keni paraqitur punime te ngjashme me objektin e prokurimit

-Nuk keni paraqitur vetdeklarimet e inxhinierëve te ndertimit,topograf dhe mjedisit

**3-U skualifikuan operatori ekonomik "DELTAREX" sh.p.k, me NUIS L92314031R,**  
për këto arsye:

1-Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 8 nuk keni deklaruar nr. E pubonjesve qe dispononi

2-Nuk keni paraqitur deshmi per punime te ngjashme pasi nuk eshte paraqitur Formulari I vleresimit per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 nga Autoriteti Kontraktor.

\* \* \*

**Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:**

**JUBICA sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z. Ndoc Kulla, me NUIS K26529001I, Adresa: Rruga “Luigj Gurakuqi”, Kukle, nr 108, Shkodër se oferta e paraqitur me nje vlere të pergjithshme prej me ofertën ekonomike me **37,950,000** (Tridhjetë e shtatemilion e nenteqind e pesedhjetemije) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkia Shkoder, Njesia e Prokurimeve. **Adresa:** Rr.”13 Dhjetori” sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 7(shtate)ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO            JO     

Me datë 30.04.2024, me shkresen me nr. 9083 prot., dt. 30.04.2024 shoqeria **RSM d.sh.h** ka paraqitur formularin e ankesës pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **Permirësimi i Sinjalistikës Horizontale dhe Vertikale në segmentet kryesore, Bashkia Shkoder** dhe publikuar ne faqen zyrtare të KPP me nr. A/2024/4032.

Me shkresën nr. **9083/1** prot date **08.05.2024** Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkoder i ka kthyer pergjigje operatorit ekonomik **RSM d.sh.h** duke hedhur poshtë pretendimet e tij dhe duke e refuzuar atë.

Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin **Nr. 542 /2024** vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” DHH, për procedurën e prokurimit “Procedura e Hapur”, me REF-98654-03-18-2024, me objekt “Përmirësimi i Sinjalistikës Horizontale dhe Vertikale në segmentet kryesore, Bashkia Shkodër”, me fond limit 41,309,221 (dyzet e një milion e treqind e nëntë mijë e dyqind e njëzet e një) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” DHH dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

A.K Bashkia Shkodër me date 30.05.2024 beri rivleresimin e procedures se prokurimit dhe pas dergimit te informacionit mbi rivleresimin , KPP me Vendimin **me nr. 618/2024** vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “ Procedura e Hapur”, me REF-98654-03-18-2024, me objekt “**Përmirësimi i Sinjalistikës Horizontale dhe Vertikale në segmentet kryesore, Bashkia Shkodër**”, me fond limit 41,309,221 (dyzet e një milion e treqind e nëntë mijë e dyqind e njëzet e një) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 03.04.2024, autoriteti kontraktor Bahkia Shkodër.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**BENET BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**  
**ZV/KRYETAR**

**ONID BEJLERI**